



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.370/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.02.2025, merr këtë:

VE N D I M

I. Refuzohen të pabazuara ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.370/2025, 371/2025, 372/2025 dhe 373/2025, të datës 04.02.2025, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025

A r s y e t i m

Me datën 04.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesat e identifikuar me numër Anr.370/2025, 371/2025, 372/2025, dhe Anr.373/2025, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

- Në ankesën Anr.370/2025, pretendohet se me 4 Shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE në Prishtinë, gjatë monitorimit të tubimeve politike, kanë vërejtur gjuhë denigruese dhe fyese nga kandidati për deputet z. Lumir Abdixhiku, në tubimin e mbajtur në qytetin e Obiliqit, me datë 02.02.2025 të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), me çka mandatin e fundit qeverisës dhe qeverinë Kurti e quan me terme të rënda dhe akuzuese si: *"qeveria ka vendosur vendin në sanksione ndërkombëtare e zbraze kombëtare "popullista nervoz (quan anëtarët e LVV-së)" e mbajnë shtetin peng për teke të tyre", "hajna" dhe akuzon për shtypje e kërcënim"*. Ndërsa në ankesën Anr.371-2025 nga njëjti subjekt politik me

pretendime për të njëjtin kandidat për deputet të subjektit politik LDK, Lumir Abdixhiku është përfshirë deklarata e tij në tubimin e lartcekur siç theksohet në ankesë, me çka mandatin e fundit qeverisës dhe Kryeministrin Kurti i quan “*hajn cep më cep*”, duke akuzuar edhe fyer me termin “*hajn*” dhe duke nxitur urrejtje ndaj sloganit të tyre në zgjedhje “cep më cep”.

Po ashtu në ankesën Anr.372-2025, po nga i njëjti tubim dhe kandidat për deputet janë përfshirë pretendimet se i njëjti ka përdorur gjuhë denigruese dhe fyese duke cekur: se mandatin e fundit qeverisës dhe Kryeministrin Kurti i quan mashtrues.

Në ankesën Anr.373/2025, pretendohet se me 4 Shkurt 2025, se Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE në Prishtinë, gjatë monitorimit të tubimeve politike, kanë vërejtur gjuhë denigruese dhe fyese nga kandidati për deputet z. Arben Gashi”, ku në postimin e tij në facebook, më datë 04.02.2025 të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), me çka e akuzon qeverinë për vjedhje të rezervaveve shtetërore, për mungesë të transparencës në tendera, kapjen e institucioneve nga familjarët dhe militantët partiak.

Sipas parashtruesit të ankesave theksohet se me këtë veprim subjekti politik LDK ka bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nënparagrafi 1.11, të Ligjit Nr.1.11, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës-LZP, me çka ka nxituar qytetarët kundër Lëvizjes Vetëvendosje dhe ka përdorur gjuhë denigruese.

Në përgjigjen në ankesa të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), theksohet si në vijim: Ankesën A.nr.370/2025, A.nr.371/2025 dhe A.nr.372/2025 në afatin e përcaktuar ligjor jep këto përgjigje:

Në përgjigjen e subjektit politik LDK theksohet se z. Lumir Abdixhiku me rastin e mbajtjes së fjalimit në Obiliq ka shkelur nenin 34 paragrafi 1, nënparagrafi 1.11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme nuk qendron, sepse fillimisht ankesat e paraqitura nga subjekti L VVjane të palejuara ngase janë parashtruar pas afatit ligjor prej 48 orësh nga shkelja e supozuar, respektivisht tubimi i LDK-së në Obiliq është mbajtur me 02.02.2025 - ora 18:00, kurse ankesa është deponuar pas 48 orësh, jo brenda 48 orësh, pra me 04.02.2025 në ora 18:05 dhe 18:10 minuta (3 ankesa për tubimin në Obiliq). Sipas subjektit politik LDK në përgjigjen e tyre kanë theksuar se pa u lëshuar në sqarime e detaje tjera, me që ankesat janë të pasafatshme kërkojnë nga PZAP që ankesat e subjektit LVV të hedhen poshte si të palejuara.

Përgjigjes si dhëshmi ka bashkangjitur fotografimin e Ftesës për tubim në Komunën e Obiliqit.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), lidhur me Ankesën A.nr.373/2025, theksohet se në rastin e ankimit nuk kanë të bëjnë me asnjë formë të gjuhës denigruese apo fyese që dërgon në akt dhune kundër personave tjerë apo pasurisë, e as gjuhë urrejtëse ndaj të tjerëve e as nxitëse për urrejtje ndaj dikujt apo diçkaje, në asnjë formë apo rrethanë tjetër. Më tutje theksojnë se përdorimi i fjalëve të tilla në debatet publike është një pjesë e normave të diskursit politik dhe është i nevojshëm për të vlerësuar dhe analizuar qëndrimet e kundërshtarëve politikë në mënyrë të drejtë dhe pa qëllime fyese, dhe është brenda kufijve të lejuarës pa nxitur urrejtje apo provokim për askënd. Në fund të përgjigjes theksojnë se gjuha e kandidatit të tyre për deputet, Arben Gashi është brenda limiteve të të lejuarës, lirisë së shprehjes dhe brenda kuadrit të demokracisë perfaqësuese, sepse fundja i njëjti asnjehere nuk ka

marrë as vërejtje për gjuhën e tij parlamentare dhe as masë ndëshkuese nga asnjë institucion tjetër.

Kërkon nga PZAP-i që ankesat e subjektit politik LVV, të refuzohen si të pabazuara.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si ne vijim: Anr.370/2025, Anr.371/2025, Anr.372/2025 dhe Anr.373/2025, janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.371/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekti i njëjtë politik LVV kundër subjektit të njëjtë politik LDK, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesat gjeti se:

-Ankesat janë të pabazuara.

Paneli, pas shikimit të shkresave të lëndës të ofruara si provë materiale, ka gjetur se kandidatët e subjektit politik LDK, dhe atë: z. Lumir Abdixhiku kandidati për deputet nga radhët e këtij subjekti politik ka deklaruar se: me çka mandatin e fundit qeverisës dhe qeverinë Kurti e quan me terme të rënda dhe akuzuese si “qeveria ka vendosur vendin në sanksione ndërkombëtare e zbrazje kombëtare "popullista nervoz (quan anëtarët e LVV-së)" e mbajnë shtetin peng për teke të tyre", "hajna" dhe akuzon për shtypje e kërcënim”, hajn cep më cep, duke akuzuar edhe fyer me termin hajn dhe duke nxitur urrejtje ndaj sloganit të tyre në zgjedhje”cep më cep” dhe mashtrues dhe kandidati për deputet nga radhët e këtij subjekti politik, z. Arben Gashi, ka deklaruar:" me çka e akuzon qeverinë për vjedhje të rezervavev shtetërore, për mungesë të transparencës në tendera, kapjen e institucioneve nga familjarët dhe militantët partiak. Paneli vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me gjuhë denigruese dhe urrejtëse në raport me subjektet politike që marrin pjesë në garën zgjedhore. Diskursi i tillë i përdorur nuk mund të konsiderohet se përdorimi i një gjuhe të tillë mund të nxit ose provokon, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, po ashtu nuk është në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11), e LZP-së, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se: *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”.*

Andaj Paneli, bazuar në provat e ofruara ka ardhur në përfundim se gjatë mbajtjes së fushatës zgjedhore të mbajtur me datë 02.02.2025 në qytetin e Obiliqit dhe deklarata për fushatë zgjedhore në facebook kandidatët për deputet nga radhët e subjektit politik LDK, ka vlerësuar se përdorimi i një gjuhe të tillë nuk bie në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11), e LZP-së.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP- së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.370/2025 më datën 07.02.2025

Kryesues i Panelit
Skender Çoçaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.